

8

M. H. 88
14/11/09



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI KOMBËTAR I UJIT
Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman

VENDIM

Nr.3 Datë 27/05/2009

“Për
miratimin e lejes për përdorim uji të imbotiluar nga shpim-pusi shoqërisë
“Shpiragu” sh.p.k”

Në mbështetje të neneve 8, 24 pika 2, të ligjit nr. 8093, datë 21.03.1996 “Për rezervat ujore”, të vendimit nr.6, datë 16.04.2004 të Këshillit Kombëtar të Ujit “Për miratimin e formularit tip të lejes për pus-shpim” dhe të vendimit nr. 4, datë 19.07.2002 të Këshillit Kombëtar të Ujit “Për miratimin e rregullores së studimit dhe shfrytëzimit të ujërave nëntokësore nëpërmjet puseve të shpimit”, Këshilli i Basenit Ujëmbledhës Seman.

VENDOSI:

1. Miratimin e lejes për përdorim uji të imbotiluar nga shpimi i pusit në fshatin Pashalli, Bashki Ura Vajgurore, Berat, shoqërisë “Shpiragu”sh.p.k.

Kordinatat e pusit jane:

X=4516420

Y=4403720

Z=45 M

Parashikohet nje prurje deri 5 l/sek.

Bashkëlidhur këtij vendimi gjeni projektin përkatës.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KBU
SEMAN
Shahin BEJDAJ

